



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



RAPORT MBI DEBATIN PUBLIK ME BANORËT E OBJEKTEVE SHUMËBANESORE NË KOMUNËN E OBILIQIT

Data	07.08.2026
Ora	18:00
Vendi	Biblioteka e Qytetit
Pjesëmarrës	25 persona – 21 burra dhe 4 gra

Qëllimi i takimit

Komuna e Obiliqit organizoi debat publik me banorët e objekteve shumëbanesore me qëllim të identifikimit të nevojave dhe problemeve prioritare në hapësirat e përbashkëta të këtyre objekteve, si dhe diskutimit të mundësive për investime, mirëmbajtje dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Takimi kishte për qëllim gjithashtu krijimin e një komunikimi të drejtpërdrejtë ndërmjet Komunës, NPL "Kastrioti" Sh.A. dhe banorëve, si dhe përcaktimin e hapave të mëtejme për adresimin e kërkesave të tyre.

Pjesëmarrësit

Në takim morën pjesë:

- Drejtori i DSHPE-së, z. Valon Svirca;
- Koordinatorin për Projekte dhe Fonde, z. Behar Gashi;
- Drejtori i DMM-së, z. Rinor Kurteshi;
- Kryeshefi Ekzekutiv i NPL "Kastrioti" Sh.A., z. Flakron Mejkiqi;
- zyrtarë komunalë;
- banorë të objekteve shumëbanesore.

Çështjet kryesore të prezantuara nga Komuna

Gjatë takimit u prezantua plani i Komunës për ndërhyrje në hapësirat e përbashkëta të objekteve shumëbanesore, me fokus të veçantë në objektet më të vjetra dhe ato me gjendje më të rënduar. U bë e ditur se janë formuar komisione nga Komuna dhe NPL “Kastrioti” Sh.A., të cilat do të bëjnë evidentimin e gjendjes dhe dëmeve në objektet shumëbanesore.

Gjithashtu, u prezantuan këto mundësi ndërhyrjeje:

- rehabilitimi dhe rregullimi i kulmeve;
- lysterja dhe mirëmbajtja e hapësirave të përbashkëta;
- përmirësimi i ndriçimit;
- mirëmbajtja e shkallëve dhe instalimeve të përbashkëta;
- përmirësimi i hapësirave gjelbëruese dhe parqeve;
- instalimi i kamerave të sigurisë;
- vendosja e çipave për qasje në hyrje;
- krijimi i këshillave të banorëve për secilën hyrje;
- lidhja e marrëveshjeve ndërmjet banorëve dhe NPL “Kastrioti” Sh.A. për mirëmbajtjen.

U theksua se ndërhyrjet do të prioritetizohen sipas gjendjes dhe nevojave të objekteve.

Kërkesat dhe shqetësimet e banorëve

Gjatë debatit, banorët paraqitën një numër kërkesash dhe shqetësimesh, ndër të cilat:

Infrastrukturë dhe mirëmbajtje

- rregullimi dhe rehabilitimi i kulmeve;
- rregullimi i hyrjeve dhe hapësirave të përbashkëta;
- ndriçimi i hyrjeve, bodrumeve dhe hapësirave përreth;
- mirëmbajtja e instalimeve të përbashkëta;
- rregullimi i kanalizimit në hapësirat e përbashkëta.

Siguria

- instalimi dhe funksionalizimi i kamerave të sigurisë;
- vendosja e çipave për qasje vetëm për banorët;
- rritja e sigurisë në hyrje dhe hapësirat përreth objekteve;
- parandalimi i vandalizmit dhe dëmtimeve të pronës së përbashkët.

Hapësirat e jashtme

- rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve;
- ujitja e hapësirave gjelbëruese;
- rregullimi i lodrave për fëmijë;
- përmirësimi i ndriçimit të parqeve;
- rregullimi i kontejnerëve;
- asfaltimi dhe përmirësimi i qasjes rrugore;
- përcaktimi i hapësirave për këmbësorë.

Parkingjet

Banorët kërkuar zgjidhje më të përshtatshme për parkingjet, veçanërisht krijimin dhe shënjimin e hapësirave të dedikuara për persona me aftësi të kufizuara.

Ashensorët

U ngrit edhe çështja e funksionalizimit dhe rehabilitimit të ashensorëve në objektet shumëbanesore. U bë e ditur se aktualisht është duke u zhvilluar studimi i fizibilitetit, pas të cilit pritet të përcaktohen hapat konkretë.

Pronësia dhe hapësirat private

Banorët ngritën edhe çështje lidhur me pronësinë, bodrumet dhe hapësirat e përdorura si lokale apo garazhe. U sqarua se këto çështje kërkojnë trajtim nga drejtoritë dhe mekanizmat përkatës komunalë.

Rregullimi i kulmeve

Një nga temat kryesore të debatit ishte gjendja e kulmeve të objekteve shumëbanesore.

U bë e ditur se për dy objektet me nga dy hyrje, përkatësisht hyrjet ku ndodhen KEDS dhe lokali XXL, parashihet **ndërrimi i tërësishëm i kulmit**, me një vlerë të parashikuar prej rreth **264,000 euro**.

Ndërhyrjet në kulme do të prioritetizohen sipas gjendjes së objekteve dhe mundësive të financimit.

Roli i NPL "Kastrioti" Sh.A.

NPL "Kastrioti" Sh.A. shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me banorët e njësive shumëbanesore për mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta.

Ndërmarrja mund të ofrojë mirëmbajtje në fusha si:

- ndriçimi;
- pastrimi dhe mirëmbajtja;
- shkallët dhe hapësirat e përbashkëta;
- hapësirat gjelbëruese;
- ndërhyrjet në instalimet e përbashkëta.

U theksua se për objektet që kanë përfunduar procedurat përkatëse dhe plotësojnë kushtet, mund të lidhen marrëveshje ndërmjet NPL "Kastrioti" Sh.A. dhe banorëve.

Krijimi i këshillave të banorëve

Një nga propozimet kryesore të takimit ishte krijimi i një këshilli prej **tre banorësh për secilën hyrje**, me qëllim që të ketë një person ose grup të identifikueshëm për komunikim me Komunën dhe NPL "Kastrioti" Sh.A.

Këta përfaqësues do të kenë rol në:

- evidentimin e problemeve;
- komunikimin me institucionet;
- përcjelljen e kërkesave të banorëve;
- koordinimin e ndërhyrjeve;
- bashkëpunimin për mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta.

Veprimet e planifikuara

Bazuar në diskutimet e zhvilluara, u identifikuan këto hapa të mëtejshëm:

1. Dalja në terren e komisioneve për evidentimin e gjendjes së objekteve dhe dëmeve.
2. Përcaktimi i prioriteteve për ndërhyrje sipas gjendjes së objekteve.
3. Përgatitja e dokumentacionit për aplikim në Fondin Kosovar për Eficiencë të Energjisë për objektin e përcaktuar.
4. Shqyrtimi i mundësisë së financimit të ndërhyrjeve të tjera me mjete vetanake të Komunës.
5. Identifikimi i mundësive për rregullimin e kulmeve dhe hapësirave të përbashkëta.
6. Inkurajimi i banorëve për krijimin e këshillave të banorëve për secilën hyrje.
7. Shqyrtimi i mundësisë për lidhjen e marrëveshjeve me NPL "Kastrioti" Sh.A. për mirëmbajtje.
8. Shqyrtimi i mundësisë për instalimin e kamerave dhe sistemeve të kontrollit të qasjes.
9. Identifikimi dhe shënjimi i parkingjeve për persona me aftësi të kufizuara.
10. Vazhdimi i studimit të fizibilitetit për ashensorët.
11. Shqyrtimi i nevojave për rehabilitimin e parqeve, ndriçimit, lodrave dhe hapësirave gjelbëruese.

Përfundim

Debati publik mundësoi një komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet Komunës së Obiliqit, NPL "Kastrioti" Sh.A. dhe banorëve të objekteve shumëbanesore.

Nga diskutimi u evidentua nevoja për ndërhyrje në infrastrukturën e përbashkët, përmirësimin e mirëmbajtjes, rritjen e sigurisë, rregullimin e hapësirave të jashtme dhe krijimin e një mekanizmi më të qëndrueshëm të komunikimit me banorët.

Komuna e Obiliqit do të vazhdojë procesin e evidentimit të nevojave në terren dhe përcaktimit të prioriteteve, duke marrë parasysh gjendjen e objekteve, urgjencën e ndërhyrjeve dhe mundësitë e financimit.

Në veçanti, u vlerësua si e rëndësishme që banorët të organizohen përmes këshillave të tyre dhe të bashkëpunojnë drejtpërdrejt me Komunën dhe NPL "Kastrioti" Sh.A., me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe mirëmbajtjes së hapësirave të përbashkëta.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik
“Objektet shumebanesore te Komunes se Obiliqit”

PROCESVERBAL

Bibiloteka e Obiliqit

Data: 07.08.2026

Ora e fillimit: 18:00

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Drejtori i DSHPE-së, z.Valon Svirca, Koordinator i Projekto dhe Fonde z. Behar Gashi, Drejtori i DMM-së, z. Rinor Kurteshi, Kryeshefi ekzekutiv i NPL “Kastrioti” Sh. A z. Flakron Mejkiqi, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Koordinator i Projekto dhe Fonde z. Behar Gashi, i cili para të pranishmëve prezantoi qëllimin e këtij mbledhimi dhe diskutoj në lidhje me investimet e mundshme në hapësirat e përbashkëta të objekteve shumë banesore, identifikimin e nevojave prioritare dhe theksoi se pret propozime, rekomandime dhe shumë bashkëpunim nga banorët për përmisimin e kushteve të jetesës në këto objekte.

Koordinatori i Projekto dhe Fonde z. Behar Gashi, diskutoj problemet që po hasin banorët e këtyre objekteve, dhe tregoi se Komisionet janë formuar nga ana e Komunës, dhe NPL “Kastrioti” Sh. A, dhe se javën që vjen do të dalin në këto hapësira dhe do të evidentojnë demet. Ai tregoi se për një ndërtesë të kane plan që të aplikojnë në Fondin Kosovë për Eficiencë të Energjisë, ndërsa me tjetrën me mjete vetanake. Ndërsa në objektet të cilat kushtet janë më të mira atëherë NPL “Kastrioti” Sh. A mund të filloj punën që nga data 1 të muajit që po vjen, kjo nëse ka marrëveshje me banorët e asaj ndërtesë. Bashkërisht me Komunën do të formojnë Këshillin e përbërë nga 3 banorë dhe të fillojnë punën.

Drejtori i DSHPE-së, z.Valon Svirca, mori fjalën dhe shprehu gatishmërinë për të qenë pranë qytetarëve nëse kanë nevojë për ndihmë. Ai shprej që pjesë e këtij takimi të jenë të gjithë “përfaqësuesit” e të gjitha njësive banesore, dhe inkurajoi që të formohen sa më shpejt këshillat e banorëve për secilën hyrje të këtyre njësive banesore. Ai tregoi shkurt se çfarë planifikohet të ndodhë në të ardhmen e afërt, lysterja, ndriqimi, rregullimi i kulmit, vendosja e çipave vetëm për

banorët rezident, ndërsa u zotua që në bashkëpunim me NPL “Kastrioti” Sh. A, të bëhet mirëmbajtja e këtyre hapësirave.

Pas prezantimit të planeve të komunës, Drejtori i DSHPE-së hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Banor që jeton tek Banesat e Hades (i njëjti nuk Prezentohet):** Jetoj në hyrjen e 5të tek Banesat e Hades, a parashihet rregullimi i kulmit tek këto ndërtesa.
- **Valon Svirca (Drejtore i DSHPE-së):** Fillimisht prioritet janë banesat e para, sepse gjendjen e kane më të vështirë. Ne këto hyrje kemi më pak punë dhe ku është më urgjente atëherë po do të punojmë.
- **Behar Gashi (Koordinator për Projekte dhe Fonde):** Te gjitha njësitë banesore janë në planë por më prioritare janë banesat para luftës, ndërsa ndërtesat të cilat janë të ndërtuara privat ne nuk mundemi të intervenojmë në to.
- **Banor në njërin nga njësitë banesore:** NPL “Kastrioti” a e ka për qëllim rregullimin e kulmeve, apo vetëm mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta.
- **Valon Svirca (Drejtore i DSHPE-së):** Kulmet i rregullon operatori, d.m.th dalim me tender, dhe operatori që fiton bënë rregullimin e kulmit, ndërsa Ndërmarrja vazhdon me mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta, me ndriçimin, gëlqerosjen, shkallët, ujin, rrymë apo çfarëdo probleme që mund të ketë prishje.
- **Naser Sallova:** Çfarë do të ndodhë më saktësisht a do të ndërrohet i gjithë kulmi apo aty ku ka nevojë do të rregullohet dëmi.
- **Behar Gashi (Koordinator për Projekte dhe Fonde):** Parashihet që të ndërrohet i gjithë kulmi për dy objektet që janë me nga dy hyrjet me kosto prej 264 mijë euro. Pra për hyrjet ku janë KEDS dhe XXL (kafene).
- **Banor që jeton në njërin nga njësitë banesore:** Kam një pyetje në lidhje me bodrumet që janë paraparë për lokale, të cilat i kanë bërë garazhdë dhe i kanë uzurpua, sepse po kemi problem me ndotjen nga zhurma, po ashtu kemi problemin e kanalizimit.
- **Behar Gashi (Koordinator për Projekte dhe Fonde):** Ne jemi këtu për hapësirat e përbashkëta dhe jo për hapësirat të cilat janë private dhe për të cilat pronarët përdorin për nevoja të tyre personale. Ndërsa sa i përket zhurmave, kanalizimit dhe uzurpimeve janë mekanizma të tjerë që merren me këto çështje.
- **Banor që jeton tek Banesat e Hades:** Desha të dije për ashensor a kemi ndonjë zhvillim a po flitet se kur do të fillohet të rregullohen.
- **Behar Gashi (Koordinator për Projekte dhe Fonde):** Vetëm po bëhet studimi i fizibilitetit dhe besoj se do të dalim me një plan konkret.
- **Besnik Krasniqi:** NPL “Kastrioti” Sh.A a është edhe për investitor privat, p.sh. te Albi market banesat që janë, ka pjesë që ende nuk janë përfunduar p.sh. dyert.
- **Flakron Mejkiqi (Kryeshefi ekzekutiv i NPL “Kastrioti” Sh. A):** Problemi i asaj ndërtese është se ende nuk është bërë pranimi teknik dhe kur të bëhet pranimi teknik është më e lehtë që ta lidhim si ndërmarrje të lidhim kontratë me banorët e asaj ndërtese, sepse më lehtë mirëmbahet, dhe për shkak se nuk është bërë pranimi teknik ne nuk e kemi pranuar si marrëveshje, sepse përndryshe si ndërmarrje jemi të hapur të bëjmë marrëveshje me secilën njësi banesore.
- **Naser Sallova:** A parashihet se kur do të fillojnë punimet?

- **Valon Svirca (Drejtor i DSHPE-së):** Nuk e dimë saktësisht, por po besoj që nga Shtatori mund të fillojmë.
- **Elfete:** A ka ndonjë vendim në lidhje me çështjen e pronësisë?
- **Behar Gashi (Koordinator për Projekte dhe Fonde):** Sa i përket çështjes së pronësisë ne mund të bëjmë edhe një takim me Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Kadastër, sepse unë mundem vetëm të aludoj dhe nuk dua të të jap informata të rrejshme.
- **Valbonë Beka:** A keni ndonjë plan për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, në lidhje me ujitjen.
- **Rinor Kurteshi (Drejtor i DMM-së):** Po jemi në procedurë për parkun tek Banesat e Kuqe, i cili do të rinovohet i gjithi, edhe tek banesat e Hades po shihet se si është dëmtuar dhe do të rregullohet nga fillimi. Edhe pse vullneti ekziston që të mirëmbahen këto hapësira por do të bëhet më e lehtë nëse do të instalohen kamerat. Mirëmbajtja po bëhet çdo ditë nga NPL "Kastrioti".
- **Adem Behrami:** Kërkoj nga ana juaj të bëhet siguria dhe mirëmbajtja e këtyre hapësirave qoftë brenda njësive banesore, por edhe jashtë hapësirave gjelbëruese, rekomandoj që të instalohen dhe kamera çipa sepse shpesh kemi hasur edhe në vjedhje të gjësendeve personale.
- **Flakron Mejkiqi (Kryeshefi ekzekutiv i NPL "Kastrioti" Sh. A):** Pajtohem plotësisht dhe ju kuptoj sepse si ndërmarrje hasim çdo ditë në mirëmbajtjen jo të mirë të parqeve, banesave kolektive, hedhjen e mbeturinave, shkatërrimet e lodrave, jemi dëshmitarë gati çdo ditë në lidhje me vandalizmin që ju bëhet këtyre hapësirave, ndërlidhem me drejtorin e DMM-së për instalimin e kamerave, sepse ne si ndërmarrje duhet të kemi bashkëpunim me juve si qytetarë në ruajtjen e këtyre ambienteve.
- **Banor:** Kërkoj nga ana juaj edhe të kemi qasje edhe ne parking për persona me aftësi të kufizuar sepse po bëhet çdo herë e më e vështirë të gjejmë parking për këta persona, kërkoj nga ana juaj të bëni një zgjidhje.
- **Valon Svirca (Drejtor i DSHPE-së):** Për parkingje për persona me aftësi të kufizuara, shpejt do të dalim dhe do të sigurojmë hapësirat aty ku është nevoja dhe i vendosim shenjat.
- Banor që jeton në Banesën e Bardhe: A është ne projekt edhe kulmi edhe asaj ndërtese.
- **Valon Svirca (Drejtor i DSHPE-së):** Jo nuk e kemi plan, por nëse ka nevojë po e shohim.
- **Banor:** Tek banesat e kuqe dhe të verdha, kam kërkesë që të bëhet rregullimi i ndriçimit tek parku dhe përreth parkut, instalimi i kamerave, rregullimin e kontejnerëve, rregullimin e lodrave për fëmijë, ofrimi i parkingjeve për këto banesa, rregullimin e banesave dhe bodrumeve, rregullimin e ndriçimit për bodrume, të kemi marrëveshje me NPL "Kastrioti", asfaltimi i rrugës mbrapa banesave, vendosja e shtyllave në mes të rrugës si dhe definimi i shiritave për këmbësor, funksionalizimi i kamerave.
- **Adem Preniqi:** Falënderoj Komunën për këtë iniciativë, çdo hyrje të bëhet një grup prej tre personave, të emërohet një person kontaktues i cili do ti adresonte problemet e hyrjes se tij.
- **Behar Gashi:** Dyert e Drejtorit të DSHPE-së janë të hapur dhe nëse ju nuk na tregoni problemin e juaj ne nuk do të mundemi të zgjidhim.

Në fund të takimit **Valon Svirca** (Drejtore i DSHPE-së), falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre, dhe të gjithë zyrtarët të cilët janë në shërbim të qytetarëve.

Takimi përfundoi në ora 18:49 me gjithsej 25 pjesëmarrës prej tyre gra 4, burra 21.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani

Emri

Mbiemri

1 Zegirja

Halima

2. Agim

Prenip

3. Visar

Pilana

4. Ekrem

Shaqi

5. Dami

Shaqi

6. Latif

Kokolli

7 Mensur

Simnica

8 Majlinda

Sallova

9, Fitim

FAZLI

10 Arben

MIRENA

11 LAUDIM

Prenip

12 DRITON

GRADJEVCI

13. FAZLI

ABAZI

14. Faime

Ramadan

5. Valbona

Bela

16. NEXAMI

SPANCA

17. ARB

ISMAILI

18 SUL

KRASNICI

18 ROSTI

HALITI

20 NAZMI

KRASNICI

21 GENC

SADIKU

Gledaj

22 GADAF

HARADINAJ

23 BAJRAM

KRASNICI

24 SEAD

HALITI

25 ELISAH

HALITI

25- Fehmi Jakupi = p Jakupi
Folter Selmani RSE